

Parathënie

Revista *Kërkime Pedagogjike* është vazhdimësi e publikimeve vjetore të Institutit Pedagogjik të Kosovës. Këtë vit, si rezultat i projekteve të shumta kërkimore, *Kërkime* del në dy vëllime. Ky publikim është vëllimi i parë i revistës *Kërkime Pedagogjike* për vitin 2025. Shtatë artikujt e këtij vëllimi përfshijnë tematika të trajtuara nga punëtorët shkencorë dhe bashkëpunëtorët e Institutit.

Vëllimi i parë vjetor i revistës *Kërkime Pedagogjike* sjell një përmbledhje studimesh që trajtojnë çështje thelbësore të zhvillimit dhe përmirësimit të praktikave pedagogjike në nivele të ndryshme të arsimit në Kosovë. Artikujt e përfshirë reflektojnë orientimin e kërkimit pedagogjik drejt analizimit kritik të proceseve në arsim, praktikat dhe politikat arsimore, si dhe ndikimin e qasjeve inovative në cilësinë e të nxënësve.

Një pjesë e këtij vëllimi i kushtohet arsimit parashkollor dhe fillor, duke trajtuar shfrytëzimin pedagogjik të mjedisit të jashtëm, integrimin e aktiviteteve fizike në punën me fëmijët e moshës 3-6 vjeç dhe zbatimin e qasjes ndërlëndore në arsimin fillor. Këto studime vënë në pah rëndësinë e planifikimit të qëllimshëm pedagogjik, zhvillimit holistik të fëmijës dhe nevojës për mbështetje profesionale dhe institucionale për edukatorët dhe mësuesit.

Në nivelin e arsimit të mesëm, artikujt adresojnë format e bashkëpunimit efektiv mësues-nxënës, rëndësinë e komunikimit në mësuesi, si dhe perceptimet për tekstet dhe materialet mësimore në shkollat profesionale. Këto punime ofrojnë të dhëna empirike mbi sfidat aktuale të praktikës shkollore, duke nxjerrë në pah nevojën për përmirësim të burimeve dhe materialeve didaktike, forcim të kompetencave profesionale të mësuesve, dhe ndërtim të marrëdhënieve bashkëpunuese, të cilat mundësojnë angazhimin aktiv të nxënësve.

Një vëmendje e veçantë i kushtohet edhe ndikimit të teknologjisë dhe inteligjencës artificiale në procesin e të nxënësve, me fokus në përdorimin e ChatGPT nga nxënësit e arsimit të mesëm. Studimi përkatës nxit reflektim kritik mbi balancimin ndërmjet përfitimeve pedagogjike, zhvillimit të

mendimit kritik, dhe ruajtjes së integritetit akademik, duke hapur diskutime të rëndësishme për politikën dhe udhëzimet etike në arsim.

Nga aspekti metodologjik, artikujt e këtij vëllimi karakterizohen nga përdorimi i qasjeve të kombinuara cilësore dhe sasore, të cilat ofrojnë një pasqyrë të thelluar të realitetit arsimor në Kosovë. Në tërësi, ky vëllim kontribuon në avancimin e diskursit pedagogjik dhe në ofrimin e rekomandimeve të bazuara në evidencë për praktikën dhe politikëbërjen arsimore.

U jemi mirënjohës dhe falënderues autorëve të punimeve, redaksisë së revistës dhe recensentëve, për kontributin e çmuar profesional në përgatitjen e punimeve në *Kërkime Pedagogjike*.

Dr. Osman Buleshkaj,

Drejtor i Institutit Pedagogjik të Kosovës